



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201701390/3**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:**                      *Rekomandim për dhënien e dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë për shtetasen V.B që nga muaji Tetor 2017, për një periudhë 9-mujore deri në mbarim të nivelit të dytë të kursit të kompjuterit.*

**Drejtuar:**                      **Znj. Voltana ADEMI**  
**Kryetare e Bashkisë**

**SHKODËR**

**Administarorit**  
**Njësia Administrative Rrethinë**

**SHKODËR**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë shtetasja V.B, banuese në Njësinë Administrative Rrethinë, Shkodër, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e plotë të dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë.

Sipas shpjegime të saj, ankuesja është përfitues i Statusit së të Verbërit, me grup të dytë të invaliditetit. Ka ndjekur kursin e kompjuterit në Qendrën Globe TIK & Language Education, Shkodër, niveli i parë dhe që nga muaji Tetor 2017 po ndjek nivelin e dytë të këtij kursi.

Ankuesja shprehet se nga Seksioni i Ndhmës dhe Përkrahjes Sociale në Njësinë Administrative Rrethinë nuk i është dhënë e drejta për të përfituar të plotë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë në bazë të VKM-së nr.277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga Statusi i të Verbërve", i ndryshuar. Asaj i është dhënë pagesa vetëm për 9 muaj ndjekje të kursit, niveli i parë dhe nuk po vijon pagesa edhe për ndjekjen e nivelit të dytë të këtij kursi. Pavarësisht se ka paraqitur vërtetimin për ndjekjen e nivelit të dytë, ka marrë përgjigje verbale se nuk i jepet dyfishi i pagesës, pasi po ndjek dy kurse.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje i të drejtave të tij ligjore, ankuesi ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Nga dokumentacioni i paraqitur pranë institucionit tonë nga ankuesja, rezulton se shtetasja V.B është studente e regjistruar pranë Qendrës Globe TIK & Language Education për të kryer kursin e Kompjuterit me nr.Amze 44. Kjo e vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga Administratori i kësaj qendre me nr.41 prot. datë 23.11.2017, kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur. *Kursi është shtrirë për një periudhë 18 mujore: 9 muaj niveli bazë i kompjuerit dhe 9 muaj niveli i avancuar i kompjuerit. Ka përfunduar nivelin bazë të kursit të kompjuerit, ku dhe është çertifikuar.*

Që nga muaji Tetor 2017 ajo po ndjek nivelin e avancuar të kursit të kompjuerit.

Në analizë të akteve ligjore e nënligjore për përfitimet e personave që gëzojnë statusin e të verbërit, konstatojmë se:

-Vendimi nr.277 datë 18.07.1997 *“Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, i ndryshuar, nuk ia kufizon të drejtën e ndjekjes së kursit të kualifikimit deri në 9 muaj personave që përfitojnë statusin e të verbërit. Në pikën 7 thuhet shprehimisht se:

*“...7 Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi përfitojnë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë.....”.*

-Udhëzimi nr.2365 datë 26.1.2008 *“Për zbatimin e VKM nr.277 datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, i ndryshuar, në pikën 7, ka përcaktuar se:

*“Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, vetëm për një shkollë, përfitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar..... ”*

Ndërsa në pikën 11 thuhet shprehimisht se:

*“Të verbërit që ndjekin kurset e kualifikimit, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumenta:*

*-Vërtetimin nga institucioni që organizon kursin, ku të jetë përcaktuar emri i kursantit, lloji i kursit dhe kohëzgjatja e tij.*

*-Vërtetim për frekuentimin e kursit, kur ai zgjat mbi 6 muaj, vërtetimi paraqitet çdo 3 muaj.*

*-Kopje e noterizuar e dëshmisë së kursit në mbarim të tij.’*

Në kushtet kur një kurs i plotë i kompjuerit zgjat 18 muaj e ndarë në dy nivele nga 9 muaj seicila si dhe kur nga ana e ankueses është paraqitur vërtetimi i ndjekjes së nivelit të dytë të kursit të kompjuerit, Seksioni i Ndihmës dhe Shërbime Sociale i Njesisë Administrative Rrethinë nuk ka zbatuar drejtë aktet nënligjore që dalin në zbatim të Ligjit nr.8098 datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* për rastin e shtetasës V.B.

Për sa më sipër, me qëllim që ankuesja të përfitojë të drejtat e saj ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **R E K O M A N D O J M Ë**

Dhënien e dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë për shtetasen V.B që nga muaji Tetor 2017, për një periudhë 9-mujore deri në mbarim të nivelit të dytë të kursit të kompjuterit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se; *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”*,

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**